



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 07-344-32032/14
Kaçanik, 31.10.2014

Në bazë të nenit 12.2 (c), 17 (n) dhe 40.2(a) të Ligjit Nr. 03/L -040 - Për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 6 të Ligjit për Transportin Rrugor, Nr. 04/L-179, si dhe nenit 6.2 (o) lidhur me nenin 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut të dt. 25.09.2008, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2014, mori këtë:

V E N D I M

Për Aprovimin e Rregullores për Transportin Rrugor në Territorin e Komunës së Kaçanikut

I.

Me këtë Vendim, Aprovohet Rregullorja 01Nr. 07-344-32032/14, më tekstin e mëtejme: Rregullorja për Transportin Rrugor në Territorin e Komunës së Kaçanikut.

II.

Qëllimi primar i kësaj Rregulloreje është rregullimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave në territorin e komunës së Kaçanikut.

III.

Rregullorja është hartuar nga Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike, përmban gjithsej 78 nene e përmbledhur në 17 faqe, dhe është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

IV.

Për zbatimin e kësaj rregulloreje, obligohet Drejtoria për Emergjencë dhe Shërbime Publike dhe shërbimet tjera relevante zbatuese të rregullores.

V.

Rregullorja hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikqyrës – MAPL-së, si dhe publikimit në web-faqen zyrtare të komunës.

VI.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 02- 04- 80/07 e datës 29.06.2007 - Për Transportin Rrugor në Territorin e Komunës së Kaçanikut.

Rregullorja iu dërgohet:

1. Kryetarit të Komunës,
2. Drejtorisë për Emergjencë dhe Shërbime Publike, përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante zbatuese të kësaj rregulloreje,
3. MAPL, dhe
4. Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi